

U publikua studimi „Reklamimi politik: Studimi krahasues për gjendjen e vendeve nga Europa Juglindore“

Shkup, 23 dhjetor 2020 – Këshilli i Evropës dhe Unioni European në kuadër të programit të përbashkët të “Instrumentit horizontal për Ballkanin Perendimor dhe Turqi 2019-2022” dhe projekti regional „Liria e shprehjes dhe Liria e mediave në Europë (JUFREKS)” e përpunoi dhe publikoi studimin – „Reklamimi politik: Studimi krahasues për gjendjen në vendet nga Europa Juglindore” .

Studimi, në përpunimin e së cilit pjesë mori edhe Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe trupat regulator shfrytëzues të JUFREKS, i adresohet reklamimit të paguar politik gjatë kohës së proceseve zgjedhore në aspekt të regulatorëve mediatik dhe jep drejtime në përputhje me standardet eurpiane dhe praktikat më të mira të asaj fushe.

Përgatitja e studimit ishte një aktivitet vijues i tryezës rajonale të rumbullakët në internet “Zgjedhjet, pandemia dhe dezinformimi”, e mbajtur më 3 korrik të këtij viti, ku organet rregullatore të rajonit ndanë përvojat.

Studimi mund të shihet në linkun: [Reklamimi politik: Studim krahasues për gjendjen në vendet e Evropës Juglindore](#)